



Në bazë të nenit 12, 17, 24 dhe 40, paragrafi 2, pika (b), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", e në mbeshtetje të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008," e konform nenit, 28, paragrafi 2, pika (b) lidhur me nenin 29, paragrafi 2, pika (c) dhe 56, të Statutit të Komunës në Suharekë, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 31.08.2022 miratoi këtë:

V E N D I M

Sipas Vendimit 01-Nr-016-12176 të datës 28.02.2022, për bartjen e mjeteve të pa shpenzuar në vitin 2021 shuma prej **924,104,82€** bartja e pjesërishtme është bërë në shumen prej **541,336.57€** kurse pjesa e projekteve kapitale të cilat nuk kanë përbushur kriteret sipas UA 06/2019 e që do të ridestinohen në shumë prej **382,768.25€**, të cilat do barten për shfrytëzim në vitin fiskal 2022

Neni 1

- 1.1 Komuna e Suharekës gjatë vitit 2021 ka tejkaluar planin buxhetor të të hyrave vetanake, në shumë prej **374,522.01€**.
- 1.2 Në vitin 2021, të hyrat vetanake kanë qenë të planifikuara, **1,812,956,00€**, ndërsa gjatë tërë vitit fiskal 2021, janë grumbulluar gjithsej shuma prej **2,187,478.01€**.
- 1.3 Bartja e të hyrave vetanake sipas Vendimit 01-Nr-016-12176 të datës 28.02.2022, është ekzekutuar pjesërisht në shumë prej **541,336.57€** por që pjesa e projekteve kapitale që kanë mbetur si keqëklasifikim i cili është vlerësuar nga Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave Punës dhe Transereve do bartet në kategorit tjera ekonomike sipas njësive buxhetore (drejtorive) si më poshtë.
- 1.4 **Tabela 1.** Kategorit ekonomike sipas njësive buxhetore (Drejtorive) si „Mallra dhe Sherbime“ dhe „Subvencione dhe Transfere“ nga pjesa e kapitaleve që nuk kanë kaluar janë 2, (dy) projekte pasi që projektet në fjalë nuk kanë patur kontrata të nënshkruara në momentin e dërgimit në Departamentin e Buxhetit në Prishtinë.

1.4.1 Projektet në fjalë janë:

1.4.2 Ndërtimi i kullës së dëshmorëve në fshatin Bllacë kodri (49243) shuma prej **8,935.00€**.

1.4.3 Rregullimi i sallës sportive në Grejkoc **projekt i RI** shuma prej **40,000.00€**

Tabela 1.

	Mallra & Sherbime	Subvencione Transfere	Invstime Kapitale	TOTAL:
Inspekcioni (16623)	10,302.58			10,302.58
Sherbimet Publike dhe Emergjente (18012)	56,729.81			56,729.81
Bujqësia e Zhv.Rural(47012)	/	109,990.01		109,990.01
Planifikim e Urbaniz. (66365)	86,049.07			86,049.07
Kultur Rini e Sport (85012)	57,761.78		8,935.00	66,696.78
Adminstrata- Arsimit (92060)	13,000.00		40,000.00	83,849.75
TOTAL:	223.843.24	109,990.01	48,935.00	382,768.25

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Suharekës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 4

Pas hyrjes në fuqi të këtij vendim i njeiti do të shërbej për bartjen dhe alokimin e mjeteve vetanake pjesërisht të mbetura nga Vendimi me numer të protokollit 01-Nr-016-12176 të datës 28.02.2022 dhe sipas kërkesës me numer të protokollit, 824 i dat 26.04.2022 pa u shfrytëzuar nga viti 2020 dhe viti 2021, e të cilat do të shfrytëzohen dhe shpenzohen në vitin fiskal 2022.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr- 016-57283
Më datë 31.08.2022



Kryesuesi i Kuvendit
[Signature]
Mr. Bexhet KUÇI

